

VENDIM
Nr. 933, datë 29.12.2014

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË QENDRËS KOMBËTARE TË
URGJENCËS MJEKËSORE

(Ndryshar me VKM nr. 250, datë 30.3.2016; nr. 185, datë 4.4.2019; nr. 70, datë 29.1.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 147/2014, “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Organika e QKUM-së të jetë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Numri i punonjësve të QKUM-së të jetë, gjithsej, 118 veta.

2. Qendra Kombëtare Urgjencës Mjekësore (QKUM) është institucioni përgjegjës për zhvillimin e sistemit të shërbimit të urgjencës mjekësore nëpërmjet planifikimit, drejtimit, pjesëmarrjes dhe bashkërendimit të të gjitha aseteve ekzistuese, në një sistem mbarështetësor të unifikuar, si dhe për bashkërendimin e veprimtarisë me sistemet e ngjashme të vendeve fqinje.

Përgjegjësitë e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM) përcaktohen, më hollësisht, në ligjin nr. 147/2014, “Për urgjencën mjekësore”.

3. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) siguron shërbim, komandim, monitorim, kontroll dhe koordinim të shërbimit kombëtar të urgjencës mjekësore, siguron shërbim dhe mbulon me personel mjekësor edhe Njësia e Transportit Mjekësor me Helikopter. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore është përgjegjëse për trajnimin e personelit mjekësor dhe paramedikal në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, sipas standardeve kombëtare e ndër-kombëtare. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore bashkëpunon me organizata të tjera kombëtare ose ndërkombëtare, të autorizuar ose të certifikuar nga institucionet përkatëse në Shqipëri apo në vende të tjera, për kryerjen e trajnimit në fushën e urgjencës mjekësore. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore lidh marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe me institucione të kujdesit shëndetësor.

4. Njësia e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore ka për detyrë bashkërendimin e komunikimit të gjithë sistemit të komandë-kontrollit të urgjencave mjekësore. Shërbimi i ofruar nga Njësia e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore mund të ofrohet edhe nga operatorë privatë, sipas legjislacionit në fuqi për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

4/1. Njësia e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore është operative 24 orë, për 7 ditë të javës, dhe koordinohet nga përgjegjësit e turnit, të cilët janë mjekë të Njesisë së Koordinimit të Urgjencave Mjekësore.

5. Marrëdhëniet e punës së personelit të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM) rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Personeli i sektorit të administratës përzgjidhet nga drejtori i qendrës. Personelin e sektorit mjekësor, të njësisë së transportit mjekësor me helikopter dhe të njësisë së koordinimit të urgjencave mjekësore përzgjedh ministri i Shëndetësisë, në bazë të konkurrimit të hapur publik, mbështetur në kërkesat e vendit të punës.

6. Qendra Kombëtare Urgjencës Mjekësore (QKUM) drejtohet nga drejtori i qendrës, i cili emërohet dhe lirohet nga ministri i Shëndetësisë. Ministri i Shëndetësisë përcakton, me udhëzim, kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të QKUM-së.

7. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të QKUM-së janë:

a) Drejtimi dhe bashkërendimi i detyrave të punonjësve, me qëllim përmbushjen me sukses të rolit të QKUM-së;

b) Bashkërendimi, pjesëmarrja dhe kontrolli i veprimtarive të trajnimit, si për personelin mjekësor ashtu edhe për paramedikalët dhe publikun e gjerë, të cilat organizohen nga vetë QKUM-ja, apo edhe nga organizata të tjera, me qëllimin e vetëm përgatitjen e mjaftueshme të tyre për të dhënë, në mënyrë cilësore, ndihmën mjekësore;

c) Menaxhimi i fondeve buxhetore dhe fondeve të tjera të krijuara, sipas legjislacionit në fuqi për funksionimin normal të QKUM-së;

ç) Miratimi i rregullores së brendshme të funksionimit të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM);

d) Bashkëpunimi i ngushtë me institucione të ndryshme dhe organizata që operojnë në fushën e urgjencës mjekësore, brenda dhe jashtë vendit, në mbështetje të procesit të trajnimit dhe certifikimit të personelit apo publikut, në fushën e urgjencës mjekësore;

dh) Përfaqësimi i QKUM-së në marrëdhënie me të tretët.

e) Drejtori i Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, për mbulimin e shërbimit me personel mjekësor në Njësinë e Transportit Mjekësor me Helikopter, për zgjedh nga njësitë e urgjencave mjekësore dhe cakton personelin mjekë e infermier sipas një grafiku të paracaktuar.

8. Pranë Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM) organizohet dhe funksionon edhe Këshilli Konsultues, si organ konsultativ i drejtorit të QKUM-së, i përbërë nga specialistë të fushës.

9. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

(Zëvendësuar me VKM nr. 250, datë 30.3.2016; nr. 185, datë 4.4.2019; zëvendësuar me VKM nr. 70, datë 29.1.2025)

Lidhja nr. 1

	ORGANIKA E QENDRËS KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE	
	Pozicioni	Nr.
1	DREJTOR I PËRGJITHSHËM	1
	Specialist	1
2	Drejtoria e Shërbimit të Urgjencave Mjekësore Paraspitalore dhe Njesisë së Koordinimit	[80]
	Drejtor mjekësor	1
	Kryeinfermier urgjence	1
	Mjek (urgjence)	26
	Infermier (urgjence)	35
	Farmacist	1
	Shofer autoambulance	16
3	Drejtoria e Statistikës, Regjistrit të Urgjencës dhe Trajnimeve	[12]
	Drejtor	1
3.1	Spektori i Trajnimeve, Certifikimeve, Akreditimit dhe Promocionit	[7]
	Përgjegjës sektori (shkenca mjekësore)	1
	Specialist (shkenca mjekësore)	3
	Specialist promocioni	2
	Specialist komunikimi	1
3.2	Spektori i Statistikës dhe i Regjistrit të Urgjencës	[4]
	Përgjegjës sektori	1
	Specialist	2
	Operator	1
4	Drejtoria e Financës, Investimeve dhe Buxhetit	[24]
	Drejtor	1
4.1	Spektori i financës dhe buxhetit	[6]
	Përgjegjës sektori	1
	Specialist (financë/buxhet)	3
	Llogaritar	1

	Specialist investimesh (ekonomist, inxhinier)	1
4.2	Spektori juridik	[4]
	Përgjegjës sektori	1
	Specialist jurist	1
	Specialist prokurimi (jurist/ekonomist/inxhinier)	2
4.3	Spektori i shërbimeve mbështetëse	[13]
	Përgjegjës sektori	1
	Specialist (burime njerëzore)	1
	Specialist investimesh (inxhinier)	1
	Specialist biomjekësor	1
	Arkivist	1
	Sanitar	3
	Magaznier	1
	Teknik i mesëm (specialitete të ndryshme)	2
	Punonjës informacioni	2
	Punonjës, gjithsej	118